

RELACIONI TEKNIK



OBJEKTI: " RIKONSTRUKSION DHE NDERTIM ÇATIE PËR
NDERTESEN E NJESISE ADMINISTRATIVE GRADISHTË "

ADRESA: FSHATI KEMISHTAJ, NJESIA ADM. GRADISHTË,
BASHKIA DIVJAKË



1. Vendndodhja.

Objekti i parashikuar për rikonstrukcion ndodhen në fshatin Kemishtaj, Njesia Administrative Gradishtë, Bashkisë Divjakë.

2. Te pergjithshme.

Territori i Bashkisë zë afro 1% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Bashkia e Divjakës në veri kufizohet me lumin Shkumbin, në lindje me Bashkinë Lushnje dhe autostraden SH 4, në jug me Bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Në përgjithësi relievi i Bashkisë Divjakë është fushor dhe i butë kodrinor.

Divjaka si Bashki ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Bashkisë Divjakë gjendet në pjesën Perendimore të Shqipërisë. Bashkia shtrihet në drejtimin veri-jug me gjatësi maksimale të vijes bregdetare prej rreth 30 km dhe lindje-perëndim me një gjatësi maksimale prej 20 km.

3. Pershkrimi i situates ekzistuese.

Objekti pjesë e këtij projekti, është në gjendje tepër të amortizuar. Gjendja e soletës në objekt është krejtësisht e amortizuar. Soleta fut lagështirën në objekt dhe për këtë arsye është parë i nevojshëm dhe i domosdoshëm ndërtimi i një çatie për permiresimin e kushteve në këtë objekt.

Rikonstrukcioni i kësaj godine ndër të tjera përfshin edhe kryerjen e suvatimeve për shkak se ka rënie të suvasë dhe lagështirë në mure.

Në objektin ekzistues nyjet higjieno-sanitare me pajisjet hidrosanitare janë pothuajse të dala jashtë funksioni.

Lagështira ka krijuar jo vetëm amortizim të strukturës por edhe prishje të sistemit elektrik.



4. Pershkrimi i konceptit te nderhyrjes urbane.

Duke qene se gjendja aktuale e godines se Njesis Administrative eshte e amortizuar lind e nevojshme qe te behet riparime. Është parashikuar te trajtohen muret e jashtme dhe te brendeshme duke u suvatuuar si dhe shtrimi i dyshemeve me pllaka. Ne projekt eshte parashikuar gjithashtu riparimi i rrjetit te tubacioneve dhe i pajisjeve hidrosanitare te banjove. Do te behet trajtimi i rrjeteve elektrik. Do te behet ndertimi i çatise se re, per eliminimin e futjes se lageshtires.

5. Pershkrimi i projektit.

Ky projekt ka si qëllim rehabilitimin e godines së amortizuar për sigurimin e kushteve minimale për punonjesit e Njesise.

Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet ndertimi i catis se re ne te gjith siperfaqen e objektit. Do të realizohet gjithashtu rikonstruksioni i suvasë në pjesët e dëmtuara si dhe suvatime të reja në rastet kur suvaja është e rrënuar plotësisht.

Do të realizohet kryerja e instalimeve të reja elektrike në përshtatje me planimetritë aktuale.

Do të kryhet rikonstruksion i dyshemesë me shtrim me pllaka grez piorcelanat.

Në objekt do të implementohen pajisjet reja hidrosanitare.

6. Organizimi i punimeve.

Punimet ne objekt do te perfundojne sipas grafikut te percaktuar qe paraqitet ne vecanti per cdo ze pune. Për realizimin me cilesi te punimeve dhe brenda afatit te percaktuar, firma ndertuese duhet te mobilizojë numrin e nevojshem te makinerive, specialisteve dhe stafin drejtues dhe te zbatoje te gjitha standartet dhe kushtet teknike dhe teknologjine e zbatimit per kryerjen e punimeve ne objekt.

Pershkrimi teknik dhe grafiku i punimeve eshte nje program i plote qe percakton rendin proceduren dhe metodën sipas se ciles firma kontraktuese propozon te punohet ne ndertimin e kesaj vepre deri ne mbarimin e plote te punes dhe perfundimin e tij.

Per organizimin e punes ne objekt do te behet ndarja e punimeve ne procese te vecanta ku do te punohet ne menyre te pavarur ne secilin proces.

Duhet te merren masa per kufizimin e levizjes se njerezve dhe te automjeteve ne zonen e ku do te kryhen punime ne menyre qe gjate kryerjes se punimeve te mos kete levizje te pakontrolluara te njerezve te cilat te pengojne ose te demtojne punimet.



7. Pershkrimi i materialeve.

Materialet qe do te perdoret per objektin “Rikonstruksion dhe ndertim çatie për ndertesen e Njesise Administrative Gradishtë” duhet te jete:

1. Llac i perzier M 25 per suvatime.
2. Pllaka porcelanat
3. Boje hidroplastike
4. Tjegulla marseljeze
5. Boje hidroplastike

8. Pershkrimi i makinerive.

Makinerite qe do te perdoren per zhvillimin e punimeve duhen te jene: betoniere e vogel, karroce dore, vegla te ndryshme per puntorine te cilet do te ndihmojne ne kryerjen e punimeve.



PROJEKTUES

Denis Hoxha
Arber Rrusho
Lesintja Trungu
Suald Toshkallari
Sanije Patozi

